



Npi – 01/156 datë: 02.05.2025

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Nenin 22 të Ligjit, Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Nenin 27 të Rregullores të QRK-së me Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008, Kuvendi i Komunës, duke shqyrtuar propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/447 të datës 23.04.2025, si dhe Rekomandimin e MAPL-së Nr.020-54/8-2025 dt.26.02.2025, në seancën e mbajtur më 02.05.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PRONËN KOMUNALE NË ZONËN KADASTRALE – SHTIME

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -VI- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 02.05.2025, me shumicën e votave miratoi Vendimin Paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale në Zonën Kadastrale Shtime, Ngastra Kadastrale me numër: P-72809093-01403-0, me sipërfaqe prej: 140629m², Kultura - Kullosë e klasit të -IV- (katër). Z.K-Shtime. Pronari/Poseduesi “Komuna e Shtimes”.

II

Kuvendi i Komunës ka marrë parasysh rekomandimin e MAPL - Nr.020-54/8-2025 dt.26.02.2025 për Rishqyrtimin e Vendimit Paraparak Npi-01/25 dt. 27.01.2025, për dhënien në shfrytëzim pronat Komunale në Z.K-Shtime, dhe ka vendosur të miratoj ndryshimin e këtij vendimi si vijon:

Është larguar paragrafi 2 i nenit -I- të Vendimit Paraparak me numër Npi-01/25 i datës 27.01.2025 në të cilin thuhej si vijon: “Ngastra Kadastrale me numër: P-72809093-02295-30, me sipërfaqe prej: 81157m², Kultura – Mal i klasit të -III- (tretë). Z.K-Shtime. Pronari/Poseduesi “Komuna e Shtimes”, me rekomandimin e MAPL-së se për paluajtshmërinë me numër të parcelës P-72809093-02295-30 me sipërfaqe prej: 81157m², nuk mundë të zhvillohen procedurat për dhënje në shfrytëzim, pasi që nuk është në listën e pronave për dhënje në shfrytëzim për vitin 2025.

III

A r s y e t i m: Paluajtshmëria Nr. P-72809093-02295-30 ka qenë pjesë përbërëse e parcelës kadastrale me Nr. P-72809093-02295-4 ku është ndërtuar Palestra Sportive dhe e njëjta ka qenë në listën e pronave të cilat do ti jepnim në shfrytëzim por, sipas detyrës zyrtare Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Zyra Kadastrale Komunale ka bërë ndarje të paluajtshmërisë me qëllim të definimit të pronës për Palestrën Sportive dhe e cila duhet të përjashtohet nga dhënja në shfrytëzim e pronës në fjalë. Me rastin e ndarjes së paluajtshmërisë

prona ka marrë numër tjetër të nën-ndarjes e cila nuk rezulton në listën e dhënjes në shfrytëzim të pronave, përkundër që parcela e lartëshënuar është derivat i parcelës së mëparshme e cila figuron në listë për dhënie në shfrytëzim. Andaj edhe drejtoria propozon ndryshimin e vendimit Npi-01/25 dt.27.01.2025, sipas rekomandimit të MAPL-së – Nr. 020-54/8-2025 dt.26.02.2025.

IV

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronave të paluajtshme të Komunës së Shtimes janë: Të mundësoj implementimin e Planit Zhvillimor Komunal 2009 – 2020, Përkrahjen e bizneseve vendore, Rritjen e punësimit, Rritjen e Investimeve, Rritjen e numrit të taksapaguesve, Zhvillimin Ekonomik, dhe të hyra më të mëdha për Buxhetin e Komunës.

V

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, do të kryhet duke u bazuar në ligjet pozitive si dhe përmes konkurrencës së hapur publike.

VI

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

VII

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi